



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHIJAK
NJESIA E PROKURIMIT**

Nr ____ Prot

Date 06.05.2026

Shtojca 13.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

Drejtuar: BE - IS SH.P.K nr Nipt K71412003A dhe Adrese: Kukes Kukes KALIS Godina Nr.2,
Heci Veleshice, Kalis, Zall Kalis, Kukes

OE/BOE me nënkontraktor

PO *JO*

OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO *JO* *X*

Tipi i Kontratës: Punë

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF- 79430-03-17-2026**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Sistemim dhe asfaltim i rrugeve ne lagjen e re “Bodinok” dhe lagjen e re “Metallaj”, te Njesisë Administrative Maminas

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 6 muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit: 21.04.2026

¹Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit : *nr 29 date 27.04.2026*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

¹ Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BE - IS SH.P.K nr Nipt K71412003A , dhe vlerë të ofertës 167.090.168 lekë pa TVSH (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milion e nëntëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tete) leke pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

2. SENKA nr Nipt J94808405Q dhe vlerë të ofertës 0 lekë pa TVSH (zero) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

3. BOE XHAŠT SHPK nr nipt K12512837I 51% MELA. nr nipt K62320011G 49% me vlerë të ofertës 172.768.785 lekë pa TVSH (njëqind e shtatëdhjetë e dy milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH .

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

4. BAMI HOLDING nr nipt J94416206R dhe vlerë të ofertës 168.756.724,50 pa tvsh (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e njëzetë e katër presje pesëdhjetë) lekë pa TVSh

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

5. BOE L.T.E CONSTRUCTION 70 % nr nipt L78006801F dhe VARAKU E 30 % Nr nipt J61902509S dhe vlerë 149.996.553 lekë pa tvsh (njëqind e dyzetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

6. ERGI nr Nipt K02727229P , dhe vlerë të ofertës 169.376.642,38 lekë pa TVSH (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë milion e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dyzetë e dy presje tridhjetë e tetë) leke pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

7. ULZA nr Nipt J67902928O , dhe vlerë të ofertës 130.937.100 lekë pa TVSH (njëqind e tridhjetë milion e nëntëqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëqin) leke pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

8. SALILLARI nr Nipt J62903125G , dhe vlerë të ofertës 115.000.000 lekë pa TVSH (njëqind e pesëmbëdhjetë milion) leke pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor
PO JO

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. SENKA nr Nipt J94808405Q dhe vlerë të ofertës 0 lekë pa TVSH (zero) lekë pa TVSH
OE/BOE me nënkontraktor

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument te kerkuar vecse ekstraktit te thjeshte te QKB.

PO JO

2. ULZA nr Nipt J67902928O , dhe vlerë të ofertës 130.937.100 lekë pa TVSH (njëqind e tridhjetë milion e nëntëqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëqin) leke pa TVSH

Nuk permbushen kriteret e DST ne piken 2.3.4 per inxhinier ndertimi profili transport

Është paraqitur deklaratë angazhimi nga subjekti ASI 2A CO, per shoqërinë ULZA me 1 Inxhinier ndertimi, Profilli transport/Drejtues Teknik.

Në kriteret e DST inxhinieri i ndëtitimit profili transport është kërkuar të jetë si Drejtues Teknik në Licensën e Shoqërisë .

Për Inxhinierin Hidroteknik është kërkuar në kriteret e tenderit sipas shtojcës nr 1 “ Nëse nuk është pjesë e licensës së shoqërisë mund të disponohet dhe me kontratë bashkëpunimi nga operatorët ekonomikë të interesuar”, kjo nuk përfshin inxhinierin e ndëtitimit në profilin transport apo inxhinierët e tjerë të kërkuar .

Nuk përmbushet kriteri 2.3.8 për certifikatat ISO :

Është paraqitur certifikata ISO EN 3834-2:2005 , e cila nuk është e përditësuar sipas kërkesave të DST në të cilën është kërkuar certifikata ISO EN 3834-2:2021.

Është paraqitur deklaratë angazhimi nga subjekti ASI 2A CO, per shoqërinë ULZA, dhe në mjetet të cilat ofrohet mbështetje , është deklaruar mjet fadromë me goma në të cilën nuk është pasqyruar Targa dhe nr i lejes së qarkullimit të mjetit . Kriteri për mjetet nuk përmbushet.

Gjithashtu oferta juaj klasifikohet anomalisht e ulet .

OE/BOE me nënkontraktor
PO JO

3. BOE L.T.E CONSTRUCTION 70 % nr nipt L78006801F dhe VARAKU E 30 % Nr nipt J61902509S dhe vlerë 149.996.553 lekë pa tvsh (njëqind e dyzetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH

Nuk plotesohet kriteri 2.3.9 , I kriterëve të DST për mjetet dhe paisjet . Eshtë deklaruar mjeti minieskavator me goma 5 ton , numri i shasise së mjetit 10394 , nuk janë hedhur të dhënat e kontratës së qerases .

Eshtë deklaruar rrull ngjeshës asfalti hekur hekur VITRAX 20/80, 10 ton me kontratë qiraje .

Numri i kërkuar për këto mjete është 2 , dhe janë paraqitur vetëm nga 1 .

Konkretisht mungojnë dy mjete 1 eskavator me goma , 1 rrull ngjeshës asfalti hekur hekur .

Eshtë paraqitur kontratë për bashkëpunimin e përkohshëm të shoqërive tregtare me nr 017 prot date 03.04.2026 dhe ndarja e punimeve L.T.E CONSTRUCTION 70 % dhe VARAKU E 30 % , Konstatohet se ndarja e punimeve të bashkimit të operatorëve ekonomikë nuk përputhet me kapacitetet profesionale të kriterit 2.3.5 midis stafit Teknik dhe kapacitetit Teknik 2.3.9 të mjeteve dhe pasiveve të deklaruara nga ana juaj.

Nuk plotesohet kriteri 2.3.1 I DST , për punën e ngjashme .

Nga verifikimet e bëra nga KVO konstatohet se ju jeni BOE të cilët keni kryer kontrata sipërmarje pune publike me bashkinë Shijak , dhe njësitë administrative , për të cilat janë paraqitur ankesa të vazhdueshme për cilësinë e punimeve si (rreshqitje dherash, çarje të asfaltit, demtime të skarpatave të rruges, bllokimi i kanaleve të kullës, spostimi i shtyllave të ndricimit etj) .

Saktësisht ju është dërguar shkresë nr 152 prot datë 13.01.2025 , për të cilën ju nuk keni marrë asnjë masë deri më sot , më pas aneksat ju janë përcjellë me shkresën nr 5002 prot datë 09.10.2025 dhe nr 1694 prot datë 02.04.2026 sërish deri më sot nga ana juaj si BOE nuk është marrë asnjë masë për të kryer përmirësimet në këto rrugë.

Sa më sipër kjo reflekton seriozitetin tuaj si bashkim operatorësh ekonomikë duke mos bërë realizimin me sukses të kontratave të zbatimit.

OE/BOE me nënkontraktor
PO JO

4. ERGI nr Nipt K02727229P , dhe vlerë të ofertës 169.376.642,38 lekë pa TVSH (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë milion e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dyzetë e dy presje tridhjetë e tetë) leke pa TVSH

Eshtë kërkuar dorëzimi i dokumentacionit në sistem të spe dhe me shkresën nr 1789 prot date 08.04.2026 , dhe nuk është paraqitur dosje fizike nga OE.

OE/BOE me nënkontraktor
PO JO

5. SALILLARI nr Nipt J62903125G , dhe vlerë të ofertës 115.000.000 lekë pa TVSH (njëqind e pesëmbëdhjetë milion) leke pa TVSH

Procedura e prokurimit eshte nen kufirin e ulet monetar , bazuar ne VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, neni 82 pika 4 ‘Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Pas përlllogaritjes oferta juaj ekonomike rezulton anomalisht e ulet.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BE - IS SH.P.K nr Nipt K71412003A dhe Adrese: Kukes Kukes KALIS Godina Nr.2, Heci Veleshice, Kalis, Zall Kalis, Kukes , se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 167.090.168 lekë pa TVSH (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milion e nëntëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tete) është identifikuar si oferta fituese .

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Drejtore Juridike Bashkise Shijak* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO JO

Personi përgjegjës për prokurimin :

A.Mehmeti

PERSONI I AUTORIZUAR

SEKRETARI I PERGJITHSHEM

TAULAND XHERAJ